

INSPEKTORATI SHITËTËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI KORRIK 2026						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti I kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	01.07.2026	Kërkesë për informacion nga një subjekt që ushtron aktivitet e tij në fushën e transportit, grumbullimin, magazinim, dhe trajtimin e vajit I përdorur për gatim (UCD), vaj I përdor I gatimit klasifikohet si mbetje jo e rrezikshme, në përputhje me Listën Evropiane të Mbetjeve, me kod 20 01 025, subjekti ka bërë përgatitjen e kartës teknologjike, dhe ka bërë aplikimin përkatës në e-albania për konformitetin e kartës teknologjike , nga e cila u kthye përgjigje që nuk është institucioni përgjegjës për certifikimin /konformitetin e kartës teknologjike, na infomoni nëse jeni institucioni kompetent për miratimin/konfirmimin e kartës teknologjike në rastin konkret.	02.07.2026	Referuar kërkesës për informacion për konfirmin/certifikim të kartës teknologjike, ju informojmë se kërkesa e dërguar nuk përshihet në detyrat ligjore të ISHTI-it, institucioni ynë miraton karta teknologjike për instalimet e naftës dhe nëprodukteve të tyre, produkti sipas kërkesës nuk kategorizohet në naftë dhe nënprodukte, për rrjedhojë kërkesa e dërguar nuk është në kompetencën e institucionit tonë.	E plotë	0
2	05.07.2026	Duam të denoncojmë vendosjen e një depoziti që përmban Gaz, që përdor për gatim pa asnjë kusht teknik siç e përçakton ligji, depozita ndodhet në zonë të banuar afër pallateve. Ju si inspektoriat e keni detyrim ligjor të merrni sa më shpejt masa ligjore para ndodhjes së ndonjë katastrofë.	10.07.2026	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrollin në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.99/2024, datë 12.9.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 32/2016 dt 24.03.2016, "Për garantimin e sigurisë së punës së pajiseve dhe instalimeve nën presion ", VKM-të Nr. 212 datë 16.03.2016, "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me GLN", VKM Nr.1062 datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion", Urdhërit të Ministrit Nr. 184 datë 05.07.2005 "Për miratimin e kushteve teknike dhe normave të projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre". Në përgjigje të ankesës tuaj protokolluar me Nr.5494 Prot, datë 06.07.2026, lidhur me vendosjen e një depozite në subjekt u bë i mundur evidentimi në terren nga inspektoret e ISHTI sipas të cilit rezultoi se, subjekti nuk dispononte pajisje nën presion. Gjithashtu subjektit ju komunikua se në rast vendosje në shfrytëzim të pajisjeve nën presion, duhet të pajiset me dokumentacionin tekniko-ligjor sipas ligjit dhe dispozitivave ligjore në fuqi.	E plotë	0
3	06.07.2026	Kërkojmë informacion për sa vijon: OE të disponojë vërtetim dhe/ose certifikim nga LSH.T.L për punime, instalime dhe mirëmbajtje të tubacioneve, apo të enëve nën presion, bazuar në ligjin Nr. 32/16 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajiseve dhe enëve nën presion", datë 24.03.2016, neni 1 dhe neni 3. Kërkojmë sqarim mbi dokumentacionin dhe procedurën e nevojshme për pajisjen me këtë vërtetim/certifikim. Shoqëria jonë ushtron këtë aktivitet prej mbi 30 vitesh dhe disponon Licencë Profesionale Duke qenë se disponojmë licencat dhe certifikimet e mësipërme, lutemi të na bëhet me dije nëse ato konsiderohen të mjaftueshme për përmbushjen e këtij kriteri, ose, në të kundërt, cilat janë kërkesat, dokumentacioni dhe procedura konkrete për pajisjen me vërtetimin dhe/ose certifikimin e LSH.T.L-s	07.07.2026	Në vijim të emaili tuaj, ju informojmë si më poshtë: detyrimi i operatorëve ekonomikë ndaj ISHTI-t konsiston në regjistrimin e të gjithë pajisjeve/instalimeve nën presion, që operatori ka në përdorim apo shfrytëzim, në zbatim të ligjit 32/2016, neni 7. Si më sipër, na vendosni në dispozicion të gjithë dokumentacionin tekniko ligjor që ju dispononi, për secilën pajisje/instalim nën presion, nëpërmjet aplikimit "Për regjistrim pajisje/instalim nën presion" në portalin e-albania.	E plotë	0
4	14.07.2026	Kërkohet informacion lidhur me rregulloren e sigurimitin dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike miratuar me Urdhrin nr 34.03/1prot, datë 30.06.2003. A ka pësuar ndryshime (përditësuar) apo është zëvendësuar komplet nga ndonjë rregullore më e re, vec versionit të 2003, kërkoj dhe versionin që është në fuqi aktualisht.	14.07.2026	Në vijim të kërkesës tuaj, administruar në ISHTI me Nr 5728 Prot, datë 14.07.2026, ju informojmë se: "Rregulloerja e Sigurimit dhe shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike "(pjesa e pare sigurimi teknik) ,miratuar me Urdhrin e ministrit të Industrisë dhe Energjitikës, Nr 3403/1 Prot, date 30.06.2003, është në fuqi pa ndryshime të tjera pasuese.	E plotë	0
5	17.07.2026	Ju lutem, dëshirojmë të marrim informacion lidhur me procedurën për kryerjen e analizave laboratorike të materialeve tekstile. Konkretisht, do të vlerësonim nëse mund të na informoni mbi: Procedurën që duhet të ndiqet për dorëzimin e mostrave dhe kryerjen e analizave; Llojet e analizave që ofron laboratorit për produktet tekstile; Koston e analizave; Afatin e nevojshëm për përfundimin e analizave dhe lëshimin e fletë-analizës. Ky informacion na nevojitet për përgatitjen e dokumentacionit në kuadër të një procedure prokurimi. Do ta vlerësonim një përgjigje sa më të shpejtë, pasi jemi në afat për përgatitjen e dokumentacionit. Ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin dhe mbetemi në pritje të përgjigjes suaj.	20.07.2026	Lidhur me kërkesen tuaj ju bejme me dije se: Cmimi për kampion (jo per tregues) është 9000 lek (te reja) dhe përshihen të gjithë treguesit për të cilët laboratorit ynë është i akredituar. Procedura që ndiqet është si më poshte vijon: 1.Paraqiteni pranë ISHTI-t me një kërkesë dhe me kampionet që doni të analizoni tek protokollit. 2. Personeli do t'ju pajisë me nje mandat bankar që duhet të paguani në bankë dhe të sillni një kopje. 3. Afati kohor për analizimin është 5 dite pune por mund të realizohen dhe me shpejt në varësi të ngarkesës që mund të ketë në laborator. 4. Treguesit e akredituar që analizohen për materiale tekstil janë: Trashësia Përmasat (gjatësi x gjerësi) Dendësia Masa për njësi sipërfaqe Lagështia Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim Krahas tyre, analizojme edhe treguesit e paakredituar të mëposhtëm: pH Lloji i thurjes sC tekstilit 5. Pas përfundimit te të gjithë procedurës ju do njoftoheni për të marre raport analizat për cdo produkt që keni sjellë.	E plotë	0
5	30.07.2026	Kam marrë një autorizim për inspektim nga institucioni juaj. Ju lutem, a mund të më ndihmoni duke më dërguar listën e dokumenteve që kërkohen për këtë inspektim?	31.07.2026	Në përgjigje të e-mailit tuaj protokolluar në ISHTI me Nr Prot 6105, datë 30.07.2026, ku kërkon listën e dokumenteve që duhet të disponojë subjekti i cili është objekt inspektimi për pajisjet, instalimet elektrike dhe makineritë ngritëse, ju dërgojmë bashkëlidhur LISTË VERIFIKIMIN PËR KËRKESAT E LUGJIT NR.8734, datë 01.02.2001, lidhur me dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit të Drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve. Instalimeve dhe Makinerive Ngritëse (DIPiEMN) mbi bazën e të cilët do të realizohet inspektimi	E plotë	0